



# ISO-POLIFONIA

“Kryevepër e trashëgimisë gojore dhe shpirtërore të njerëzimit”, UNESCO



“A Masterpiece of oral and intangible heritage of humanity”

[www.isopolifonia.com](http://www.isopolifonia.com)

Newsletter; Maj 2012, Nr. 6

“Muzika në procesin e edukimit artistik të fëmijëve”-Refleksion mbi kontributin e ri të akademikut Vasil S. Tole në fushën mësimdhënies së lëndës së muzikës në arsimin 9-vjeçar. Botohet seria e teksteve të “Edukimit Muzikor” për klasën e 5-të, 6-të, 7-të, 8-të dhe 9-të, të shtëpisë botuese “MEDIAPRINT”

*Mikaela Minga, muzikologe*

“Muzika në procesin e edukimit artistik të fëmijëve”-Refleksion mbi kontributin e ri të akademikut Vasil S. Tole në fushën mësimdhënies së lëndës së muzikës në arsimin 9-vjeçar.

-Botohet seria e teksteve të “Edukimit Muzikor” për klasën e 5-të, 6-të, 7-të, 8-të dhe 9-të, të shtëpisë botuese “MEDIAPRINT”

Kohët e fundit, problematikat e edukimit mbi muzikën janë kthyer në qendër të vëmendjes. Kjo duke marrë parasysh faktin se shumë fëmijë dhe të rinj njohin si pika referimi për muzikën variantet e shumta të muzikës komerciale, të cilat ç’është e vërteta, qarkullojnë lirshëm para tyre. Sa i takon muzikës së madhe, të paktë janë ata që dëgjojnë apo kanë informacion rreth zhvillimeve të saj historike e bashkëkohore, qofshin këto brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj. Kjo është një nga arsytet pse në kuadrin e reformimit të përgjithshëm të sistemit arsimor i është kushtuar një vëmendje e veçantë edhe hartimit të programeve përkatëse të lëndës së muzikës. Sigurisht, faktorët që ndikojnë një situatë të tillë janë të shumtë dhe nuk përqendrohen vetëm te shkollat; megjithatë, shkolla si institucioni kryesor i edukimit ka pjesën më të rëndësishme, për të ndikuar dhe për të përmirësuar një situatë të tillë. Në këtë kuadër, ashtu si çdo disiplinë tjetër, edhe muzika duhet mësuar dhe ky proces nuk ka të bëjë thjesht me edukimin e veshit muzikor. Para së gjithash, ai lidhet me njohjen e muzikës si art dhe vendit inteligjent që ajo ka në jetën e njeriut.

Vasil S. Tole, një personalitet i afirmuar tashmë në çështjet e muzikës dhe të trashëgimisë sonë kulturore, është angazhuar prej disa kohësh me një problematikë të tillë dhe në sajë të përvojës së tij të gjerë si studiues, kompozitor dhe etnomuzikolog, ai vjen me ciklin e plotë të librave të muzikës për shkollat 9-vjeçare. Nëpërmjet kësaj serie ai synon të sjellë përpara nxënësit një metodë mësimore të plotë, e cila të mund ta shoqërojë atë hap pas hapi dhe në mënyrë sistematike gjatë të pesë viteve të shkollës. Për vitin e ri shkollor 2012-2013 do të jenë në duart e nxënësve seria e librave për klasën e 5-të, 6-të, 7-të, 8-të dhe 9-të, të shtëpisë botuese “MEDIAPRINT”.

Ashtu si e përmenda edhe pak më sipër, procesi i edukimit muzikor ka specifikat e veta, të cilat nënkuptojnë qoftë mësimin e një kënge të thjeshtë, ashtu edhe mësimin e asaj çfarë është kënga në muzikë. Si rrjedhojë, prof. Vaso Tole i është referuar përvojës bashkëkohore evropiane të edukimit muzikor, në të cilën jo rastësisht,

një ndër themeluesit kryesorë të saj është edhe kompozitori e studiuesi Zoltan Kodai, një figurë shumë e rëndësishme e muzikës në shek. XX. Mbi këtë bazë, akademiku Vasil S. Tole bën një përzgjedhje të kujdesshme të materialit dhe të lëndës përkatëse, duke bashkuar qoftë anën praktike të të mësuarit, siç mund të jetë, për shembull, mësimi i himnit kombëtar, i shkrimit muzikor, etj., me anën inteligjente, që është ndërgjegjësimi i nxënësit për atë çfarë përfaqëson himni për një komb, ose si paraqitet historia e shkrimit muzikor. Këto janë dy principet themelore mbi të cilat mbështetet metoda e tij, por ai nuk mjaftohet vetëm me kaq. Duke i marrë këto si pika orientimi, ai e zgjeron më tej lëndën dhe materialin e ofruar. Kështu, duke iu referuar sërish shembujve të mësipërm, vërejmë që nga koncepti i himnit kombëtar, nxënësi kalon në formë të shkallëzuar tek njohuritë për këngën patriotike dhe nga shkrimi muzikor, ai kalon tek veçoritë dalluese të gjuhës muzikore. I njëjti koncept shoqëron të gjithë kapitujt si: “Luajtja në instrumentet muzikore”, “Dëgjimi muzikor” dhe “Shprehja dhe krijimi muzikor”.

Krahas kësaj, akademiku Vaso Tole është përpjekur që nxënësi të njihet edhe me një çështje tjetër të rëndësishme: atë të trashëgimisë kulturore të një vendi dhe vendit që muzika ka brenda saj. Kjo është një problematikë e re në procesin e edukimit, por shumë e rëndësishme për zhvillimet bashkëkohore të tij. Në këtë mënyrë, nxënësi njihet nga afër me ato cilësi të veçanta të kulturës muzikore kombëtare, siç është fjala vjen, muzika iso-polifonike e Shqipërisë së jugut, këngët e veriut, këngët qytetare shqiptare, etj. Nëpërmjet tyre ai mësohet të vlerësojë atë sistem vlerash autentike që qëndron në themel të çdo kombi. Duke i njohur në mënyrë profesionale, ai ndërgjegjësohet kështu jo vetëm për muzikën, por edhe për konceptin e trashëgimisë kulturore në tërësi.

Njohuritë vijnë në mënyrë të shkallëzuar nga njëra klasë tek tjetra, gjë që i ndihmon një formimi muzikor më të plotë. Kështu, pasi nxënësi është njohur me problematikat kryesore, ai vazhdon të thellohet më tej dhe të zgjerojë këndin e tyre. Kjo është edhe një ndër përparësitë e këtij cikli librash të krijuar nga i njëjti autor, krahasuar me libra të autorëve të ndryshëm. Në vend që nxënësi të kalojë për pesë vjet me radhë nga një metodikë tek një tjetër, në këtë rast, ai e ka më të lehtë të orientohet dhe t’i marrë njohuritë në mënyrë sistematike.

Qëllimi kryesor i edukimit muzikor duhet të jetë afrimi i fëmijëve me botën e tingujve dhe me mesazhet që muzika përcjell, dhe kjo duhet të vijë në mënyrë sa më të thjeshtë dhe komunikuese. Akademiku ynë ka sjellë pikërisht një gjë të tillë. Nëpërmjet librave të tij, nxënësi ka mundësinë që të mësojë rreth muzikës, ta kuptojë atë, ta këndojë dhe interpretojë si dhe të dëfrehet dhe të gjejë kënaqësi mes tingujve të saj.

“Pesë të drejtat muzikore bazë”

Këshilli Ndërkombëtar i Muzikës/IMC është organizata globale e organizmave të specializuara muzikore dhe e ekspertëve të cilët punojnë në fushën e muzikës. Krijuar në vitin 1949 nga UNESCO, këshilli është mandatar që të promovojë diversitetin muzikor dhe të mbështesë të drejtat kulturore muzikore për të gjithë njerëzit. Ky këshill, përmes programit të “Forumit të III-të botëror të muzikës”, mbështet përhapjen e pesë të drejtave muzikore bazë, në të gjitha vendet e botës.

Ato janë:

- a) Të drejtën që kanë të gjithë fëmijët dhe adoleshentët që të shprehen muzikalisht me lirinë e mundshme të shprehjes.
- b) Të drejtën që kanë të gjithë fëmijët dhe adoleshentët që të mësojnë gjuhën dhe aftësitë muzikore.
- c) Të drejtën që kanë të gjithë fëmijët dhe adoleshentët për të patur akses tek zhvillimet muzikore përmes pjesë-

- d) Të drejtën për artistët e muzikës që të zhvillojnë artin e tyre përmes të gjitha mediave, me lehtësitë e duhura në dispozicion të tyre.
- e) Të drejtën për artistët e muzikës që të sigurojnë njohjen dhe shpërblimin për veprën e tyre muzikore.

Shqipëria përfaqësohet në Këshillin Ndërkombëtar të Muzikës/IMC përmes Këshillit të Muzikës Shqiptare, anëtar i IMC/UNESCO i krijuar në vitin 1999.

<http://www.imc-cim.org/>

*Refleksion mbi kontributin e ri të akademikut Vasil S. Tole në fushën e mësimdhënies së lëndës së muzikës në arsimin 9-vjeçar*

**MIKELA BINGA\***

Koncepti i fundit, problematikat e edukimit mbi muzikën janë këtyre në qendër të vëmendjes. Kjo duke marrë parasysh faktin se abstrakteshja dhe të rinj njohin si pika referimi për muzikën vlerat e shumta të muzikës komerciale, të cilat ç’është e vërteta, qëkillojnë lëshim para tyre. Sa i takon muzikës së madhe, të pakët janë ata që dëgjojnë apo kanë informacion rreth shkëlqimeve të saj historike e bashkëkohore, qëndrin këtu brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj. Kjo është një nga arsyet për të kushtuar e reformimit të përgjithshëm të sistemit arsimor i është kushtuar një vëmendje e veçantë edhe hartimit të programeve përkatëse të lëndës së muzikës. Sigurisht, faktori që ndikojnë në shkurtr të tillë janë të shumtë dhe nuk përqendrohen vetëm te shkollat, megjithatë, shkolla si institucioni kryesor i edukimit ka pjesën më të rëndësishme, për të edukuar dhe për të përmirësuar një situatë të tillë. Në këtë kuadër, ashtu si çdo disiplinë tjetër, edhe muzika duhet mësuar dhe ky proces më ka të bëjë thjesht me edukimin e veshit muzikor. Pasi të gjithë, ai lidhet me njohjen e muzikës si art dhe vendit inteligjent që ajo ka në jetën e njeriut. Vasil S. Tole, një personalitet i afirmuar mësues në çështjet e muzikës dhe të trashëgimisë së kulturës, është angazhuar prej disa kohësh me një problematikë të tillë dhe në sajë të përvojës së tij të gjerë si studiues, kompozitor dhe etnomuzikolog, ai vjen me cilën e plotë të librave të muzikës për shkollat 9-vjeçare. Nëpërmjet kësaj serie ai synon të sjellë përpara mësuesit një metodë mësimore të plotë, e cila si mund të shpërfaqet atë hap pas hapi dhe në mënyrë sistematike gjatë të pesë viteve të shkollës. Për vitin që vjen, do të jenë në dritë e mësimore dy prej librave të kësaj cikël përkatësisht libet i klasës së pestë dhe ai i klasës së gjashtë. Ashtu si e përmenda edhe pak më sipër, procesi i edukimit muzikor ka specifikat e veta, të cilat nënkuptojnë qëllim mësimor e një këngë të thjeshtë, ashtu edhe mësimin e asaj çfarë është kënga në muzikë. Si rrethojë, prof. Vaso Tole i është referuar përvojës bashkëkohore evropiane të edukimit muzikor, në të cilën jo rastësisht, një ndër themeluesit kryesorë të saj është edhe kompozitori e studiuesi Zoltan Kodai, një figurë shumë e rëndësishme e muzikës në shek. XX. Mbi këtë bazë, akademiku Vasil S. Tole bën një përzgjedhje të kujdesshme të materialit dhe të lëndës përkatëse, duke bashkuar qoftë anën praktike të të mësuarit, siç mund të jetë, për shembull, mësimi i himnit kombëtar, i shkrimit muzikor, etj., me anën inteligjente, që është ndërgjegjësimi i mësuesit për atë çfarë përfaqëson himni për një komb, ose si paraqitet historia e shkrimit muzikor. Këto janë dy principet themelore mbi të cilat mbështetet metoda e tij, por ai nuk mjaftohet vetëm me kaq. Duke i marrë këto si pika orientimi, ai e zgjeron më tej lëndën dhe materialin e ofruar. Kështu, duke iu referuar sërish shembujve të mësipërm, vërejmë që nga koncepti i himnit kombëtar, mësuesi kalon në formë të shkallëzuar tek njohuritë për këngën patriotike dhe nga shkrimi muzikor, ai kalon tek veçoritë dalluese të gjuhës muzikore. I njëjti koncept shoqëron të gjithë kapitujt si: “Luajtja në instrumentet muzikore”, “Dëgjimi muzikor” dhe “Shprehja dhe krijimi muzikor”. Krahas kësaj, akademiku Vaso Tole është përpjekur që mësuesi të njihet edhe me një çështje tjetër të rëndësishme: atë të trashëgimisë kulturore të një vendi dhe vendit që muzika ka brenda saj. Kjo është një problematikë e re në procesin e edukimit, por shumë e rëndësishme për zhvillimet bashkëkohore të tij. Në këtë mënyrë, mësuesi njihet nga afër me ato cilësi të veçanta të kulturës muzikore kombëtare, siç është fjala vjen, muzika iso-polifonike e Shqipërisë së jugut, këngët e veriut, këngët qytetare shqiptare, etj. Nëpërmjet tyre ai mësohet të vlerësojë atë sistem vlerash autentike që qëndron në themel të çdo kombi. Duke i njohur në mënyrë profesionale, ai ndërgjegjësohet kështu jo vetëm për muzikën, por edhe për konceptin e trashëgimisë kulturore në tërësi. Njohuritë vijnë në mënyrë të shkallëzuar nga njëra klasë tek tjetra, gjë që i ndihmon në një formim muzikor më të plotë. Kështu, pasi nxënësi është njohur me problematikat kryesore, ai vazhdon të thellohet më tej dhe të zgjerojë këndin e tyre. Kjo është edhe një ndër përparësitë e këtij cikli librash të krijuar nga i njëjti autor, krahasuar me libra të autorëve të ndryshëm. Në vend që nxënësi të kalojë për pesë vjet me radhë nga një metodikë tek një tjetër, në këtë rast, ai e ka më të lehtë të orientohet dhe t’i marrë njohuritë në mënyrë sistematike. Qëllimi kryesor i edukimit muzikor duhet të jetë afrimi i fëmijëve me botën e tingujve dhe me mesazhet që muzika përcjell, dhe kjo duhet të vijë në mënyrë sa më të thjeshtë dhe komunikuese. Tole ka sjellë pikërisht një gjë të tillë. Nëpërmjet librave të tij, mësuesi ka mundësinë që të mësojë rreth muzikës, ta kuptojë atë, ta këndojë dhe interpretojë si dhe të dëfrehet dhe të gjejë kënaqësi mes tingujve të saj.

**“Pesë të drejtat muzikore bazë”**  
Këshilli Ndërkombëtar i Muzikës/IMC është organizata globale e organizmave të specializuara muzikore dhe e ekspertëve të cilët punojnë në fushën e muzikës. Krijuar në vitin 1949 nga UNESCO, këshilli është mandatar që të promovojë diversitetin muzikor dhe të mbështesë të drejtat kulturore muzikore për të gjithë njerëzit. Ky këshill, përmes programit të “Forumit të III-të botëror të muzikës”, mbështet përhapjen e pesë të drejtave muzikore bazë, në të gjitha vendet e botës.

**\*Muzikolog**



# Muzika në procesin e edukimit artistik të fëmijëve



